

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË / Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Kujtim Krasniqi, me Zyrtaren Ligjore Arbëresha Kukalaj, në çështjen penale kunder te pandehurit F.B. nga P., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 3013/18, të datës 29.05.2018, jashtë seancës, me date: 25.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr. 3013/18, të datës 29.05.2018, për shqiptimin e urdhërit ndëshkimor,

Andaj gjykata konform nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari;

F.B., nga i ati F., dhe e ëma E. e gjinsë M., i lindur me ... ne P., me vendbanim në rr. "E.K." B. ..., me numër persoanal ..., Shqiptar – shtetas e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 23.05.2018, rreth orës 21"30, në oborrin e QKUK-së, në Prishtinë, hetuesit e DHTN-së duke vepruar në teren, e kanë ndaluar të pandehurin, ku gjatë kontrollimit të tij, i janë gjetur dy qese me substancë narkotike e llojit marihuanë, me peshë prej 2.7 gram,

- **me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**
- Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **300 (treqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjës së formës së prerë të këtij aktgjykimi

Dënimin e shqiptuar i pandehuri duhet ta paguaj deri në 3 (tri) këste mujore në afat kohor prej 3 (tre) muaj, deri me datë 5 të muajit vijues nga dita e marrjes së formës së prerë e këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata mundësinë e pagesës me këste do ta revokoj dhe konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

Konfiskohet: Substanca narkotike me ngjyrë të gjelbërt e llojit kanabis (marihuanë), tetrahidrokanibol (THC), pesha neto 2.7 gram

Obligohet: I akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë në mënyrë shumën prej **50 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr. 3013/18, të datës 29.05.2018, kundër të akuzuarit F.B. nga P., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshojë Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Kallëzimi penal, Vërtetimi mbi konfiskimin e gjesendëve të datës 23.05.2018, dhe Raporti i ekspertizës nga Agjensia e Kosovës për Forenzikë, Raporti i shpejtë i policisë, fotodokumentacioni, Deklarata e te pandehurit, si dhe provat tjera përcjellëse janë prova të mjaftushme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Posedimi I paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 275, par.3 të KPPK-së, gjykata vendosi për konfiskimin e substancës narkotike e llojit Marihuan (tetrahidrokanibol – THC) pesha neto 2.7 gram.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr. 2531/18, të dt. 25.09.2018

Zyrtare Ligjore,
Arbëresha Kukalaj

Gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.